

## NË KËTË NUMËR

- NËNSHKRUHET MEMORANDUMI I BASHKËPUNIMIT MIDIS SHOQATËS SË SIGURUESVE TË SHQIPËRISË DHE ASAJ TË KOSOVËS.
- KRIJOHET GRUPI I PËRBASHKET I PUNËS PER ZHVILLIMIN E TREGUT.
- ZHVILLIMET E TREGUT TË SIGURIMEVE NË SHQIPËRI PËR PERIU DHËN JANAR-KORRIK 2018
- ALBSIG ME BRAND TË RI.



### NËNSHKRUHET MEMORANDUMI I BASHKËPUNIMIT MIDIS SHOQATËS SË SIGURUESVE TË SHQIPËRISË DHE ASAJ TË KOSOVËS.

Më 16 Korrik 2018 u nënshkrua në Tiranë Memorandumi i Bashkëpunimit midis Shoqatës së Siguruesve të Shqipërisë dhe asaj të Kosovës.

Për palën shqiptare, dokumenti u nënshkrua nga zj.Fitnete Sulaj, Kryetare e Shoqatës së Siguruesve të Shqipërisë dhe për palën kosovare nga z. Sami Mazreku, Drejtor Ekzekutiv i Shoqatës së Sigurimeve të Kosovës.

Marrëveshja e nënshkruar parashikon mbrojtjen e interesit të kompanive të sigurimeve, promovimin e integritetit, stabilitetit dhe efikasitetit të tregut të sigurimeve, si dhe vendosjen e formave të bashkëpunimit ndërmjet palëve për të përmirësuar veprimtaritë respektive të interesave që ato përfaqësojnë.

Palët do të punojnë së bashku për të identifikuar dhe adresuar mbështetje teknike dhe kapacitete trajnuese për të zhvilluar më tej tregun e sigurimeve në Shqipëri dhe Kosovë.

Në kuadër të këtij memorandumi të bashkëpunimit, palët parashikojnë të zgjerojnë dhe lehtësojnë shkëmbimin e njohurive përmes seminareve, trajnimeve, konferencave, vizitave konsultative të ekspertëve, shkëmbimin e praktikave më të mira, etj.

Gjatë vizitës së tij në Tiranë, z.Mazreku ka patur edhe një takim me z.Ervin Koçi, Drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, ku kanë diskutuar për rritjen e bashkëpunimit të të dy vendeve në fushën e industrisë së sigurimeve.

### KRIJOHET GRUPI I PËRBASHKËT I PUNËS PËR ZHVILLIMIN E TREGUT.

Në zbatim të rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë "Për vlerësimin e veprimtarisë së AMF-së për vitin 2017", më datë 13 korrik 2018 drejtuesit më të lartë të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare zhvilluan një takim të zgjeruar me drejtorët e përgjithshëm të shoqërive të sigurimit të jetës, përfaqësuesit e BSHS-së dhe të Shoqatës së Siguruesve të Shqipërisë.

Në takim u diskutuan disa çështje kryesore që lidhen me mbarëvajtjen e tregut të sigurimeve si dhe me perspektivat e zhvillimit të mëtejshëm të tij.

Ndër të tjera, me rëndësi të veçantë në këtë takim ishte dakortësia për ngritjen e një grupi të përbashkët pune nën koordinimin e Shoqatës së Siguruesve për të përcaktuar potencialet e zhvillimit të tregut të sigurimeve, si dhe për të parë

Promovojmë  
praktikat dhe  
standartet më të  
larta në fushën  
e sigurimeve,  
në mbrojtje të  
interesave të  
konsumatorëve.

SHOQATA E SIGURUESVE TË  
SHQIPËRISË

Rr. "Ibrahim Rugova",  
Pall 21/4, Kati i dytë  
Tiranë

Email: [info@shoqatasiguruesve.al](mailto:info@shoqatasiguruesve.al)  
[www.shoqatasiguruesve.al](http://www.shoqatasiguruesve.al)

mundësinë e propozimit të akteve ligjore dhe nënligjore në funksion të zhvillimit të tregut dhe mbrojtjes së konsumatorit.

Në takimin e tij të parë të zhvilluar më datë 29 Gusht 2018, grupi i punës, pasi u njoh me situatën aktuale të tregut përcaktoi edhe drejtimet kryesore të punës për periudhat e ardhshme.



## ALBSIG ME BRAND TË RI.



Shoqëria e Sigurimeve Albsig sh.a vjen me një brand të ri. Gjatë 14 viteve në treg, shoqëria ka zhvilluar dhe përmirësuar ndjeshëm gamën dhe cilësinë e produkteve. Pikërisht, ndryshimi i logos së ALBSIG, është pjesë e strategjisë për përshtatjen imazhit të saj me cilësinë e shërbimeve që ajo ofron

Emblema e re e Albsig, siguron një burim avantazhi konkurrues duke integruar vizionin, kulturën dhe vlerat e shoqërisë me sistemet dhe rrjetet e komunikimit.

Duke ruajtur konturet e logos së mëparshme, simbolika e logos së re është bërë e thjeshtë për të qenë lehtësisht e fiksuar në memorjen e konsumatorëve.

Është ruajtur emri, ALBSIG dhe ngjyra e logotipit të mëparshëm si dhe janë përfshirë në të elementë të përkrenares së Skënderbeut, ç'ka reflekton statusin organik të ALBSIG-ut si pjesë e Kastrati Group.

## ZHVILLIMET E TREGUT TË SIGURIMEVE NË SHQIPËRI PËR PERIUDHËN JANAR-KORRIK 2018

- Në janar – korrik 2018 tregu i sigurimeve ka pasur një rritje prej 6.28%. Volumi i primeve të shkruara bruto është rritur me 556,723 mijë lekë duke arritur shifrën 9,424,563 mijë lekë.
- Numri i kontratave arriti në 697,059 duke shënuar një rritje me 7.72 % krahasuar me janar – korrik 2017.
- Volumi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jo-Jetës kapi shifrën 8,736,152 mijë lekë duke shënuar një rritje në masën 7.07% krahasuar me janar- korrik 2017.
- Numri i kontratave në sigurimin e Jo-Jetës kapi shifrën 623,773 duke shënuar një rritje në masën 8.92% krahasuar me janar – korrik 2017.
- Gjatë janar-korrik 2018, janë paguar gjithsej 2,672,798 mijë lekë dëme ose 13.35% më pak se gjatë periudhës janar-korrik 2017.
- Numri i dëmeve të paguara në janar – korrik 2018 është ulur me 2,884 dhe arriti shifrën 25,434 nga të cilat 24,435 dëme janë paguar nga shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës dhe 999 nga shoqëritë e sigurimit të Jetës.

TREGUESIT KRYESORË TË TREGUT TE SIGURIMEVE JO-JETË			
	viti 2018		Ndryshimi në %
	Janar-Korrik 2017	Janar-Korrik 2018	
Primet e shkruara bruto	8,159,375	8,736,152	7.07
nga kjo:			
përgjegjësi motorrike ndaj palëve të treta	5,296,905	5,691,536	7.45
MTPL e brendshme	4,192,163	4,604,932	9.85
Kartoni Jeshil	879,780	874,905	(0.55)
Kufitare	224,962	211,699	(5.90)
Dëmet e paguara bruto	2,896,096	2,533,497	(12.52)
Numri i kontratave të nëshkruara	572,712	623,773	8.92
Numri i dëmeve të paguara	27,302	24,435	(10.50)

## ANËTARËT E SHOQATËS SË SIGURUESVE TË SHQIPËRISË



Vlerat që na bashkojnë.

